



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

PËR/ZA/TO:	Minire Begaj – UD, udheheqese e dpt. Ligjor pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale				
NGA:	Valon PRESTRESHI – Kryetar i AKK-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Mendim profesional mbi nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për shpërndarjen e pagesave te skemes se Ndhimes Sociale ndermjet MPMS-BPB-PK sh.a, -				
Nr. i zyrës:	1	Lokacioni:	Prishtinë	Data:	08.06.2017
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	

E nderuara znj. Begaj

Bazuar në emailin tuaj të datë 18 Prill 2017 për dhënjen e Mendim Profesional mbi nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për shpërndarjen e pagesave të skemës së Ndhimës Sociale ndërmjet MPMS-BPB-PK sh.a

Baza Ligjore

Në mbështetje të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 28 paragrafi 1 pika 1.7, 1.11, neni 23 pika 1 dhe 2 , Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës me 8 Qershor, 2017 jep këtë:

Mendim Profesional

1. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, është në zbatim të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet, në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit të Kosovës, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
2. Autoriteti thekson se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve, të cilët janë potencial për t'u angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) në përgjithësi është e padëshirueshme nga pikëpamja e konkurrencës prandaj rekomandojmë, që numri i konkurrenteve - operatoreve ekonomik të mos kufizohet, dhe të njejtit të mos vendosen në pozita të pafavorshme konkurruese.
3. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës rekomandon Autoritetin kontraktues (MPMS), që t'i referohet Vendimit PSH Nr.590/15 të datës 30 Dhjetor 2015 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.